



Prishtinë, 14 tetor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1186_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 7 nënparagrafet 7.2, Nenit 16 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, Nenit 26 dhe Nenin 54 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Vendimin e Rregullatorit V_1107_2019 për Miratimin Përfundimtar të Certifikimit të KOSTT SH.A si Operator i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike;
- Opinionin 02/19, e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për Certifikimin e KOSTT/OST, të datës 01.02.2019, të nxjerrë në pajtim me Nenin 3 (1) të Rregullores (EC) Nr. 714/2009 dhe Nenin 10 (6) të Direktivës 2009/72/EC,
- Kërkesën e KOSTT "Njoftim lidhur me emërimin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë", për miratimin e zyrtarit të pajtueshmërisë nga Rregullatori, të datës 14.06.2019.

Në seancën e mbajtur me datë 14 tetor 2019, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** kërkesa e KOSTT SH.A për emërimin e Znj. Mimoza Byqmeti si **Zyrtare e Pajtueshmërisë** së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (KOSTT SH.A).

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 14.06.2019 ka pranuar nga KOSTT Kërkesën si dhe CV-në (biografinë) e Znj. Mimoza Byqmeti, për miratimin e saj nga Rregullatori si zyrtare e pajtueshmërisë së KOSTT/OST.
- o Rregullatori me vendimin V_1107_2019 për Miratimin Përfundimtar të Certifikimit të KOSTT, përveç tjerash ka kërkuar nga KOSTT të caktoj Zyrtarin e Pajtueshmërisë dhe ta dërgoj në Rregullator për miratim.



- Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të jetë i pavarur, të ketë qasje në të gjitha informatat e KOSTT dhe të raportoj në Rregulator në pajtim me Programin e Pajtueshmërisë së KOSTT dhe dispozitat tjera të legjislacionit në fuqi.
- Në rast se për çfarëdo arsye, Zyrtari i Pajtueshmërisë shkarkohet apo dorëhiqet nga kjo pozitë ai do të raportoj për periudhën paraprake lidhur me pajtueshmëritë.
- KOSTT do të dorëzoj në Rregulator Kërkesën për emërimin e zyrtarit tjetër të pajtueshmërisë jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e shkarkimit apo dorëheqës së zyrtarit të pajtueshmërisë, të miratuar me këtë vendim.
- Zyrtari i Pajtueshmërisë gjatë gjithë mandatit të tij/saj dhe me qëllim të kryerjes së detyrave të përcaktuara me Programin e Pajtueshmërisë dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm, duhet të jetë plotësisht i pavarur dhe të ketë qasje në të gjitha informatat e OST.
- ZRRE, pas vlerësimit të Kërkesës së KOSTT, biografisë së Znj. Byqmeti dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

II. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT SH.A dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i Rregullatorit:



Arsim Janova, U.D. kryesues


Besim Sejfi, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Bushiti, anëtar